

Rajon

Përleshje e armatosur në Prishtinë, tre të lënduar

21 By Desk | 18/07/2023 21:09

Share

f

Twitter

WhatsApp

Email



TË FUNDIT

Maqedoni | 19/07/2023 11:31

Izet Mexhiti flet për vrasjet e fundit në Shkup

Maqedoni | 19/07/2023 11:22

Izet Mexhiti: Me Arben Taravarin jemi miq të vjetër

Maqedoni | 19/07/2023 11:13

Kovačevski: Si shoqëri jemi shembull për Europën! Shpresoj që deputetët të marrin guximin për të votuar ndryshimet kushtetuese

Maqedoni | 19/07/2023 11:10

“E kam lutur deri në qiell”, Izet Mexhiti thotë që nuk ka çfarë të diskutojë më me Ali Ahmetin

Maqedoni | 19/07/2023 10:53

Grubi: Ec te shpia tani merre valixhen/ Mexhiti: Provokim i ulët

Tre persona kanë mbetur të lënduar pas një përleshjeje fizike, në vendin e ngjarjes është gjetur edhe një armë zjarri.

Rasti ka ndodhur të martën” në rrugën “Ibrahim Lutfiu” në Prishtinë.

Lajmin për portalin rtv21.tv e ka konfirmuar zëdhënësja e Policisë për rajonin e Prishtinës, Flora Ahmeti.

“Sot rreth orës 20:00, policia ka marrë informatën për një përleshje fizike në rrugën “Ibrahim Lutfiu” në Prishtinë. Menjëherë pas marrjes së informatës policia ka dalë në vendin e ngjarjes dhe ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që konsistojnë në hetimin e rrethanave që karakterizojnë ngjarjen. Bazuar në të dhënat fillestare dyshohet se gjatë përleshjes, janë lënduar tre persona, njëri prej tyre është shoqëruar në stacion policor. Në vendin e ngjarjes policia ka gjetë një armë zjarri dhe po kryen procedurat e sekuestrimit. Aktualisht hetuesit policor në koordinim me prokurorinë, po ndërmarrin veprimet hetimore për ndriçimin e plotë të rastit”, ka thënë Ahmeti.**/21Media**

Share

f

Twitter

WhatsApp

Email



Desk